

PAKETA FISKALE 2020

POLITIKAT E REJA FISKALE 2020

Ndryshimet në Paketën Fiskale 2020 prekin ligjet si vijon:

- ✓ Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ✓ Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

I. Tatimi mbi të ardhurat

i. Tatimi mbi të ardhurat personale

- Të punësuarit në më shumë se një punëdhënës, pavarësisht se nuk e kalojnë kufirin vjetor të të ardhurave 2 milion lekë duhet të dorëzojnë deklaratë individuale (DIVA) dhe paguajnë tatim progresiv mbi të ardhurat personale për shumën totale të pagave në më shumë se një punëdhënës.

ii. Promovimin e sportit, me qëllim rritjen e impaktit pozitiv të tij në shoqëri, ku:

- Sponsorizimi për sportin rritet në 5% të fitimit para tatimit nga 3% që është aktualisht.
- Për kompanitë që realizojnë mbi 100 milion lekë fitim, njihet si shpenzim i zbritshëm 3-fish i shumës së sponsorizuar.

iii. Industria automotive

- Norma e tatim fitimit ulet në 5%, për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në këtë industri.

iv. Për investime mbi 1 miliard lekë

- Zgjatje e afatit të mbartjes së humbjeve nga 3 në 5 vjet.

III. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

- i. Harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar në vendin tonë lidhur me faturimin, me përcaktimet e projektligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili sjell një risi në procesin e faturimit dhe monitorimit dhe transaksioneve.

IV. Proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë

- i. Harmonizimin e dispozitave përkatëse të ligjit për proçedurat tatimore, me përcaktimet e projektligjit për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, i cili sjell një risi në proçesin e faturimit dhe monitorimit të transaksioneve;
- ii. Lidhjen e një marrëveshje për detyrimet që administrata tatimore ka ndaj tatimpaguesve për TVSH-në e rimbursueshme, sipas një plani pagese të dakordësuar me tatimpaguesin. Ky parashikim do të zbatohet deri më 30.06.2021
- iii. Kompesimin e detyrimeve tatimore ndërmjet administratës tatimore dhe administratës doganore sipas proçedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.
- iv. Zgjerimi i objektit për lidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste për detyrimet e tatimpaguesve edhe për detyrimet e vetdeklaruar për tvsh si dhe për sigurimet shoqërore në raste specifike për institucionet buxhetore.
- v. Ndryshimi i deklaratës së tatimpaguesit vetëm një herë brenda 36 muajve dhe për sigurimet shoqërore vetëm një herë në muajin pasardhës.
- vi. Njoftim i tatimpaguesit para kontrollit dhe vizitës fiskale nga 30 ditë dhe 10 ditë bëhen përkatësisht 10 dhe 5 ditë.
- vii. Harmonizimi dhe unifikimin e kundravajtjeve administrative që lidhen me çështjet e ku është parashikuar sistem i shkallëzuar penaltetesh për shkeljet tatimore në lidhje me moslëshimin e faturave nga tatimpaguesit bazuar në madhësinë e biznesit:
 - o 50 mijë lekë gjobë biznesi i vogël pa TVSH;
 - o 100 mijë lekë gjobë biznesi i vogël me TVSH;
 - o 150 mijë lekë gjobë biznesi i madh.

V. Taksat Kombëtare

- i. Saktësime të nevojshme që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë të ligjit nga DPSHTRR lidhur me aplikimin e dispozitave të këtij ligji;
- ii. Ndryshimin e përcaktimeve të vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushë një automjet për t'u konsideruar automjet luksi, duke e amortizuar vlerën e automjetit me 10% me vlerë të mbetur;
- iii. Ndryshime në penaltet me qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura me gjokat e aplikuar sipas ligjit "Për proçedurat Tatimore";
- iv. Aplikim i komisionit që përfiton DPSHTRR, prej 5(pesë) përqind për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze;
- v. Taksat mbi automjetet
 - o për automjetet e hershme me interes historik dhe koleksionimin sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
 - o për automjetet e invalidëve, veteranëve, invalidëve të verbërve.